

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**“LUSHNJA SHOES” SH.P.K.**

Sot, më date **17.06.2021**, une i nënshkruari:

- **Bruno Sguazzardo** lindur me **02/10/1951**, shtetas Italian, lindur ne Verona (VR) dhe me rezidence ne Itali, me adrese leje banimi ne Lagja “Clirimi” shetitorja e palmave pallati “Zdravo”, Identifikuar nepermjet pasaportes numer. **YA4831339**, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar....; në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” kam vendosur të themeloje një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emëruar **“LUSHNJA SHOES” SH.P.K.** (më poshtë referuar si “Shoqëria”), duke nënshkruar këtë Akt Themelimi. Aktiviteti i kësaj Shoqërie do të rregullohet nga Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij Akti Themelimi dhe i bashkëngjitet si Shtojca 1.

**Neni 1**

Emri i Shoqërisë është: **“LUSHNJA SHOES” SH.P.K.**

**Neni 2**

(1)Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Lagja “Kadri Qystri”, rruga “Darsia” Nr.9 zona kadastrale 8571 me numer pasurie.7/89-3 Lushnje .

(2)Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: *brunosguazzardo@yahoo.it*  
Shoqëria ka te drejte te hape dege apo filiale ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise.

**Neni 3**

-Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë 10 vjet dhe fillon qe prej dates se regjistrimit te saj ne Regjistrin e Shoqerive Tregtare ne Qendren Kombetare te Biznesit.

**Neni 4**

**Objekti**

Shoqëria do të kryej aktivitetin e mëposhtëm :



Linje per perpunimin, transformimin dhe prodhimin e kepuceve. Sandaleve te te gjitha llojeve si dhe suprinave te te gjithave llojeve, konsulence ne fushen e kepucarise. Ekport-Import te lendeve te para qe lidhen me perpunimin e prodhimin e kepuceve, sandaleve te te gjitha llojeve si dhe surpinave te te gjitha llojrave. Veprimtari private ne fushen e tregtise me shumice dhe pakice, import-eksport te mallrave te ndryshme industriale, lendeve dhe materialeve te ndertimit, materialeve inerte, pjeseve te kembimit te mjeteve , makinerive e paisjeve hidrosanitare, elektro-shtepiake, elektronike, elektrike , mjete kancelarie , punime druri, mobilje, dyer, dritare, duralumini, materiale plastike. Punime e skelete hekuri, servis automjetesh, agjensi shitblerje e qiraje. Veprimtari ne fushen e regjimit te perpunimit aktiv te kepuceve, perpunime per te trete, etje .

-Megjitheate shoqeria ka te drejte qe te shtoje dhe te ndryshoje objektin e veprimtarise se saj me vendim te asamblese se ortakeve.

## **Neni 5**

### **Kapitali themeltar**

(1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **100 000** (njqind mije) Lekë

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues **Z. Bruno Sguazzardo**: Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme prej **100 000** (njqind mije) Leke që përbën **100 %** të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve do të jetë në para.

## **Neni 6:**

### **Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

Shtimi ose pakesimi i kapitalit themelor mund te behet vetem pasi Asamblea e ortakeve me shumice e ka dekretuar kete dhe per me teper te gjithe ortaket jane te detyruar qe ta repektojne dhe te kontribuojne ne para ose ne natyre ne baze te vendimit te shumices se asamblese

## **Neni 7:**

### **Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit te një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e te drejtat që rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen pëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë
- b) shitblerjes;(me te drejten e parablerjes nga ana e ortakeve).
- c) trashëgimise;



- d) dhurimit;
- e) cdo menyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë ligjerisht të trasferueshme ndërmjet ortakëve, përsa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltare janë ligjerisht të trasferueshme me rrugë trashgimnie.

## **Neni 8**

### **Organi Vendimmarres**

Asambleja e Ortakeve është organi i vetem vendimmarrës i shoqërisë. Asambleja e Ortakeve është organi i vetem vendimmarrës i shoqërisë që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, kuorumi, marrja e vendimeve ,përfundimi nga e drejta e votës dhe te tjera modalitete per funksionimin e organit vendimmarres percaktohen ne statutin e shoqërisë.

## **Neni 9**

### **Administrimi**

Administrator i shoqërisë emerohet **Z. Kujtim Dakaj** lindur me 07/10/1983, shtetas shqiptar, lindur ne Salihi dhe me residence ne Lushnje, mbajtes i leternjoftimit nr.034838035, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i zgjedhur per nje periudhe 5 vjecare me te drejte rizgjedhje.

Kompetencat dhe përgjegjësitë e Administratorit janë të përcaktuara qarte ne statutin e shoqërisë.

## **Neni 10**

### **Viti financiar-ekspertët**

Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar pregatit raportin me shkrim për nxierien e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ia paraqesë e ta dorëzojë në kohë ortakëve për ti shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.



## Neni 11

### Prishja-riorganizimi i shoqërisë

Modalitetet për prishjen dhe riorganizimin e shoqërisë janë të përcaktuara në statutin e shoqërisë në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

## Neni 12

Akti i Themelimit është hartuar në 4 kopje origjinale.

### ORTAKU I VETEM I SHOQËRISE

Bruno Sguazzardo

BRUNO SGUAZZARDO

*Sguazzardo Bruno*